



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Ko Med” LLC të datës 26.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje mjekësore për nevojat e shëndetësisë primare QMU, QKMF dhe njësitë e saj” me nr. të prokurimit 616-24-4262-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRAOHET pjesërisht** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Ko Med” Sh.P.K. të datës 26.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje mjekësore për nevojat e shëndetësisë primare QMU, QKMF dhe njësitë e saj” me nr. të prokurimit 616-24-4262-1-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik “Ko Med” Sh.P.K. (tutje si “parashtruesi”) me datë 26.06.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje mjekësore për nevojat e shëndetësisë primare QMU, QKMF dhe njësitë e saj” me nr. të prokurimit 616-24-4262-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit janë se “ Per te gjitha keto pretendime nga Autoriteti Kontraktues , me poshte mund ti gjeni sqarimet qe i kemi pranuar nga prodhuesit:**

**1.Defibrilatori – E ka ofruar 3h monitorim (kerkesa eshte 5h monitorim) 1.Nese shikohet ne katallogun e prodhuesit mund te verehet se monitorimi eshte 3h minimum pra qe do te thot se maksimumin e ka ashtu siç eshte kerkuar , per kete ne kemi kontaktuar prap prodhuesin dhe na ka konfirmuar.**

**2.Karrika per evakuim – I mungojne specifikat e baterise 2.Ne broshuren bazike te ofruar nga prodhuesi shkruan se Battery Life eshte 90 min dhe nuk mund te thuhet se mungojn specifikat e baterise.Perderisa sa stafit i nevojitet ta ken si informat vetem sa kohe mund te punoj Karrika me bateri. Por ne prap e kemi pyetur prodhuesin dhe na ka derguar sqarime shtese (mund ti gjeni bashkangjitur) sa i perket specifikave me te detajuara per baterin dhe mbushesin. Gjithashtu shkruan se (and one full charge provides enough power to last for 150 flights of stairs.), qe e deshmon se eshte nje prej Karrikave me te perfeksionuara ne treg. Bashkangjitur mund ta gjeni edhe User Manual qe ta shikoni paraprakisht se sa praktike eshte.**

**3.Ultraze mobil – ofron vetem sonden pa monitor 3.Ne si OE me nje pervoje shume vjeçare ne fushen e mjeksise e dim se nuk mund te ofrohet vetem sonda sepse ajo duhet te kete nje lidhje per ta shfaqur imazhin.Prandaj ju lutem shikoni faqen 2 te katallogut tek sonda dhe mund ta vereni Tablet Monitorin.Monitori eshte i perfshire ne oferte dhe gjithashtu ne qe te jemi me korrekt prap kemi kerkuar nga prodhuesi specifika me te detajuara per Tablet Monitorin. Bashkangjitur I gjeni specifikat me te detajuara per monitorin dhe deklaraten nga kompania KO MED L.L.C se monitori eshte i perfshire ne oferte dhe do te liferohet identik ashtu siç eshte kerkuara nga Autoriteti kontraktues”.**

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsye si në vijim:

*Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit .Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim,*

*Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :  
OE KO MED L.L.C.811564948 i mungojnë*

**DEFIBRILATORI - E ka ofruar 3h monitorim (kërkesa është 5h monitorim)**

**KARRIKA PER EVAKUIM - I mungojnë specifikat e baterisë**

**ULTRAZE MOBIL - Ofron vetëm sondën pa monitor**

Përmes administrimit me ofertën e parashtruesit është gjetur se në ofertën e parashtruesit defibrilatori është ofruar me kapacitet minimum 3h monitorim ndërsa kërkesa në dosjen e tenderit ka qenë 5h monitorim. Në dosjen e tenderit nuk është cekur nëse kapaciteti duhet të jetë minimum 5h ose maksimum 5h por vetëm është kërkuar 5h. Duke marrë parasysh sqarimet e ofruara nga parashtruesi përmes kërkesës për rishqyrtim, del se kapaciteti i monitorit të parashtruesit është minimum 3h mirëpo e arrin edhe kapacitetin 5h sipas nevojës. Prandaj ky pretendim është i bazuar pjesërisht.

Sa i përket pikës për karrikën për evakuim, sipas dosjes së tenderit nuk është cekur se cilat specifika duhet të ketë bateria. Megjithatë në broshurë janë disa specifika sa i përket jetëgjatësisë së baterisë. Përderisa nuk është cekur se specifikisht në DT se cilat specifika duhet të përmbahen, asnjë kërkesë e DT nuk mund të interpretohet në disfavor të OE. Prandaj edhe ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Sa i përket pikës për ultrazërin në katalogun e parashtruesit është gjetur se sonda është bashkë me monitor, prandaj nuk qëndron arsyetimi i komisionit vlerësues ndërsa pretendimi ankimor është i bazuar.

Lidhur me të tri pikat e pretendimit ankimor respektivisht tri arsytet e eliminimit të parashtruesit, komisioni rivlerësues ka mundësi që të kërkoj sqarime shtesë në kuptim të nenit 72 të LPP. Në kuptim të nenit 62 të LPP, anulimi i një aktiviteti të prokurimit mund të bëhet vetëm si mundësi e fundit ashtu që paraprakisht të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për shmangien e anulimit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 02.07.2024**

**Visar SHEHU**  
  
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës  


**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.